

MENDIM PAKICE

Unë, komisioner Lulzim Hamitaj, si anëtar i trupit gjykues, nuk pajtohem me vendimin e marrë nga kolegët e shumicës për të shkuar në vendimmarrje përfundimtare për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Dritan Marku - pa kryer hetime shtesë dhe vetëm me një kriter të rivlerësimit. Kjo për shkak se niveli i provueshmërisë në kriterin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, sipas mendimit të pakicës, në momentin e mbylljes së hetimit administrativ dhe, për më tepër, pas prapësimeve të paraqitura nga subjekti, nuk arriti një nivel provueshmërie të mjaftueshëm në rivlerësimin e pasurisë për të përmbyllur rivlerësimin e tij me një vendim përfundimtar, vetëm mbi këtë kriter dhe do të duhej të kryhej një hetim i mëtejshëm për disa rrethana të cilat do të shtjellohen më tej. Pra, do të duhej të ishte rihapur hetimi administrativ, jo vetëm për disa qartësime më të thelluara lidhur me kriterin e pasurisë, por edhe në lidhje me kriterin e figurës dhe të aftësive profesionale, në të cilat mund të konstatoheshin elemente që do të kristalizoheshin në gjetje konkrete, e kësaj do të mundësonin një vendimmarrje përfundimtare më të plotë dhe të bazuar në një vlerësim të përgjithshëm të të tria kriterëve të ndërthurura. Shkaqet konkrete të këtij qëndrimi të pakicës janë si në vijim:

- i. Lidhur me burimet financiare të huadhënësit F. A. mendoj se duhet të konsiderohen të ardhurat të realizuara prej tij në vitin 2000 nga shitja e aksioneve të një shoqërie tregtare, për sa kohë kjo shitje ka qenë e formalizuar dhe e depozituar në organet kompetente duke prodhuar efektet e saj me kalimin e tyre në emër të blerësve (dhe nuk bëhet fjalë për një burim të pretenduar nga të ardhurat nga një biznes) dhe, për rrjedhojë, mendohet se tatimet janë paguar në momentin e kryerjes së transaksionit. Gjithsesi, për sa kohë tatimi duhej të paguhej vetëm mbi vlerën/përfitimin e shtuar (pra, çmim shitje minus çmim blerje), edhe nëse do të konsideronim vetëm shumën e vlerës fillestare të aksioneve të shoqërisë me burim të ligjshëm, për sa kohë nuk i nënshtrohet tatimit do të gjendeshim përballë një disponibiliteti financiar mëse të mjaftueshëm nga shtetasi F. A., për dhënien e huas prej 1.000.000 lekësh në favor të subjektit në vitin 2005. Gjithashtu, nëse kjo mundësi nuk do të merrej e mirëqenë, pikërisht lidhur me këtë pikë, mendoj se do të kishte nevojë për një hetim shtesë për të qartësuar vlerën e çmimit fillestar, e cila duhej të konsiderohej si burim i ligjshëm financiar për huadhënësin. Nga ana tjetër, duhet të mbahet në vëmendje fakti që kuotat e shoqërisë objekt shitje, në datën 14.11.2000, në favor të shoqërisë “****” S.A. Honduras, kundrejt shumës 165.000 USD, kanë qenë një transaksion i kryer me një shoqëri të huaj dhe prezumohet se tatimi është paguar në momentin e regjistrimit të tyre në favor të blerësit. Edhe në këtë rast do të ishte nevoja për të hetuar dhe analizuar më në detaj legjislacionin përkatës dhe kontekstin e transaksionit.
- ii. Gjithashtu, vërehet se lidhur me këtë huadhënës rezultoi edhe një tjetër burim shtesë, që lidhet me shpërndarjen e dividendëve, pikërisht në vitin 2005 (kur është dhënë huaja), në shumën prej 292.860 lekësh, e cila do të mund të konsiderohet si një burim alternativ, për sa kohë citimi ose specifikimi nga subjekti i një burimi të një personi të tretë (person tjetër i lidhur), mes disa burimeve të realizuara prej këtij të fundit, nuk mund të përjashtojë marrjen në konsideratë të burimeve të tjera, për sa kohë ato konstatohen dhe provohen përgjatë procesit të rivlerësimit dhe nuk janë pjesë e sferës së ngushtë financiare të subjektit, për të cilat do të duhet të ishte bërë deklarimi i mëhershëm. Kjo për shkak se personi tjetër i lidhur (huadhënësi), jo vetëm që nuk ka qenë subjekt deklarues, por edhe mund të mos të ketë qenë i saktë dhe i plotë në përgjigjen që i ka dhënë subjektit mbi burimet e tij financiare dhe kjo nuk mund të penalizojë subjektin, për sa kohë saktësimi i burimeve të personave të tretë bëhet përgjatë hetimit administrativ dhe mbi të gjitha kur burimet financiare rezultojnë të ligjshme nuk mund të injorohen nga Komisioni. Në këtë

pikë, diferenca e burimeve të nevojshme për mundësimin e huadhënies do të ishte rreth 700.000 lekë, shumë që – siç u shpreh edhe më sipër – konsiderohet e mbuluar nga çmimi fillestar i blerjes së aksioneve, pasi logjika ekonomike të çon në konkluzionin që një send ose një e drejtë reale që shitet në vlerën 165.000 USD, nuk mund të jetë blerë në më pak se 7.000 USD – për sa kohë ajo nuk mund të gjenerohej nga shitësi (huadhënësi) me kosto zero. Pikërisht edhe nëse vetëm 7.000 USD do të konsideroheshin me burim të ligjshëm, nga shitja në fjalë, ato do të mjaftonin për të mundësuar huadhënien prej 1.000.000 lekësh në favor të subjektit, për sa kohë ekzistonte edhe burimi i ligjshëm nga dividendi i vitit 2005, në shumën prej 292.860 lekësh, burim i cili nuk është marrë në konsideratë nga shumica. Rrjedhimisht, duke konsideruar këtë shumë dhe së paku 7.000 USD si të ardhur e patatueshme nga shitja e aksioneve si më lart, nuk do të gjendeshim përballë një pamundësie financiare të huadhënësit F. A.. Përndryshe, nëse as shuma prej 7.000 USD nuk do të vlerësohej si e disponueshme në rrugë të ligjshme, atëherë do të duhej të riçelej hetimi administrativ dhe t'i kërkohej subjektit që të paraqiste kontratën e huadhënësit, lidhur me blerjen e aksioneve që, më pas, në datën 14.11.2000, ky i fundit ka shitur në favor të shoqërisë “***” S.A. Honduras, kundrejt shumës 165.000 USD. Ky veprim hetimor do të ishte i dobishëm për të evituar penalizimin e subjektit pa e njohur plotësisht realitetin dhe kontestin faktik, pasi në këtë mënyrë do të mund të përllogaritej saktësisht pjesa përbërëse e vlerës prej 165.000 USD, që nuk i nënshtrohej detyrimit tatimor dhe që mund të konsiderohej si e disponueshme nga huadhënësi. Ky verifikim qartësues nuk mund të anashkalohej me arsyetimin se ishte detyrim i subjektit për të paraqitur të gjithë dokumentacionin përkatës, pasi në rastin konkret, përpos nevojës imponuese për qartësimin e Komisionit nëpërmjet hetimit, subjekti ka paraqitur kontratën e shitjes të sipërcituar si burim direkt i mjeteve monetare të huadhënësit dhe specifikimet apo qartësimet e mëtejshme duhet t'i rikërkoheshin subjektit ose të hetoheshin kryesisht nga Komisioni.

- iii. Lidhur me burimet e ligjshme të huadhënësit tjetër, shtetasit K. D., vërehet se ndonëse është provuar mjaftueshmëria e disponibilitetit financiar të shoqërisë “***” sh.p.k. dhe i huadhënësit si ortak i vetëm i saj, është konstatuar një konfuzion i fondeve përkatëse lidhur me administrimin apo përdorimin e të ardhurave me burime të ligjshme (fitime të shoqërisë). Vlerësohet se mospërshtkrimi në mënyrë të saktë në librat e një shoqërie me një ortak të vetëm, nuk mund të përjashtojë në mënyrë absolute përdorimin e këtyre fondeve nga ortaku edhe në cilësinë individit – në konfuzion pikërisht me pozicionin e ortakut të vetëm, që mund të disponojë të ardhura nga fitimet e shoqërisë, të cilat në vetvete i janë nënshtruar pagesës së tatimit. Në këto kushte, moskonsiderimi me burim të ligjshëm i huas së marrë nga shtetasi K. D., do të passillte një penalizim të subjektit, jo për pamundësi financiare të huadhënësit në këndvështrimin substancial, por për shkak të parregullsive formale/burokratike të huadhënësit/ortakut të vetëm, që nuk ka përshkruar me saktësi lëvizjet e arkës apo detyrimin që ai vetë kishte ndaj shoqërisë së tij. Gjithsesi, edhe nëse kjo hua nuk do të vlerësohej si e provuar me burim të ligjshëm, nisur nga rrethanat e lartpërmenduar dhe nën dritën e parimit të proporcionalitetit, kjo mungesë financiare prej vetëm 1,000,000 lekësh, parë në aspektin sasior dhe në kontekstin specifik të ekzistencës së fondeve të përdorura nga huadhënësi, nuk mund të përbënte në vetvete shkak për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit.
- iv. Përpos pretendimeve të tjera të subjektit në rrafshin financiar dhe rezervave të pakicës të shprehura më sipër, nisur nga rezultati final i analizës financiare të arritur nga shumica për pasurinë nr. 1, me pamundësi mjeteve monetare në vlerën 2.200.000 lekë, thjesht duke zbritur nga kjo shifër vetëm huan prej 1.000.000 lekësh, të marrë nga shtetasi F. A., që sipas pakicës mund të konsiderohej me burim të ligjshëm, do të gjendeshim përballë një pamjaftueshmërie të burimeve financiare të ligjshme prej rreth 1.200.000 lekë, shumë e cila gjithsesi, parë edhe nën dritën e parimit të proporcionalitetit, nuk mund të përbënte shkak për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit. Kjo nuk do të thotë që subjekti do të duhej

të konfirmohet në detyrë, por në kushtet e mungesës së një niveli të lartë provueshmërie mbi pamjaftueshmërinë financiare, riçelja e hetimit administrativ do të plotësonte kuadrin e përgjithshëm me elemente shtesë, të dobishëm për të mbërritur në një vendimmarrje sa më objektive, të bazuar në rezultate gjithëpërfshirëse, të cilat mund të vlerësoheshin në tërësinë e tyre dhe mund të gërshetoheshin midis tyre, nëse do të ishte rasti, duke çuar në një vendim më të plotë.

- v. Gjithashtu, pakica nuk është dakord me konkluzionet e shumicës në faqen 16, përkatësit pikat 131 dhe 132, lidhur me moskonsiderimin e të ardhurave të realizuara nga subjekti në bazë të kontratës së shitjes së apartamentit të tij (pasuria nr. 1 – ndonëse rezulton i provuar jo vetëm veprimi juridik, por edhe kalimi i shumave monetare në favor të subjektit) dhe me cenimin e besimit të publikut për shkak të nënshkrimit të kësaj kontrate. Pakica mendon se një kontratë nuk mund të vlerësohet dhe konsiderohet vetëm duke u limituar në titullin e saj, pasi sikurse parashikojnë dispozitat ligjore përkatëse, interpretimi i kontratës duhet të bëhet në bazë të përmbajtjes së saj, të efekteve që ka prodhuar dhe të sjelljes së palëve. Në këtë këndvështrim, në rastin konkret, ndonëse titulli i kontratës është shënuar “kontratë kapari”, nga një analizë e thjeshtë e përmbajtjes së saj bie ky përkufizim titullues, pasi aty është parashikuar kryerja e disa pagesave me këste, në data të ndryshme, sikurse ato edhe *de facto* janë kryer midis palëve me këste, ndërkohë që kontrata e kaparit ka krejt një tjetër strukturë dhe qëllim. Ndryshimi thelbësor qëndron në faktin se kontrata e kaparit parashikon vetëm pagesën e një shume si paradhënie nga pala blerëse e ardhshme në formë garancie, shumë e cila nuk mund të kthehet pas nëse blerja finale nuk konkretizohet për faj të palës që ka dhënë kaparin. Pra, kontrata e kaparit nuk mund të parashikojë/përshkruajë të gjitha pagesat me këste deri në likuidimin total të çmimit, sikurse është parashikuar në kontratën e nënshkruar nga subjekti, detaje këto që janë karakteristika pikërisht të kontratës së shitjes apo të porosisë së një pasurie. Në këto kushte, tipologjia e kontratës *de qua* duhet të kualifikohet në bazë të parashikimeve dhe efekteve që ka prodhuar, për sa kohë edhe sjellja e palëve ka qenë koherente me parashikimet kontraktore, të cilat nuk mund të kualifikohen dhe konsiderohen si një kontratë kapari.
- vi. Nisur nga sa më lart, sipas pakicës, nuk mund të mos konsiderohen si të ardhura me burim të ligjshëm shumat e përfituara nga shitja e një pasurie, përpos titullit të kontratës, për sa kohë veprimet juridiko-financiare midis palëve kanë qenë konsekuente dhe në harmoni me përmbajtjen e kontratës në fjalë. Moskonsiderimi në analizë financiare të këtyre të ardhurave – plotësisht të dokumentuara si lidhur me shkakun/objektin ashtu edhe lidhur me transferimin e tyre në favor të subjektit – shkon kundër realitetit të provuar si në aspektin juridik ashtu edhe në kuadrin faktik. Dyshimet mbi mospërputhjen e titullit të kontratës me përmbajtjen e saj dhe me veprimet financiare të kryera konkretisht, duhet të çojnë në vlerësimin e realitetit se ndodhemi përballë një kontrate porosie dhe jo të injorohet realiteti i provuar, për hir të një titulli të kontratës në fjalë, që nuk ka qenë ai i duhuri. Gjithashtu, dyshimet mbi çuarjen e qëllimshme të këtij titulli në kontratën e nënshkruar nga subjekti, për të mos konkretizuar kalimin e pronësisë, por thjesht për të mundësuar një disponibilitet financiar, bien ndesh me realitetin për sa kohë kjo pasuri ka kaluar përfundimisht në pronësi të blerësit edhe *de jure*, sikurse ka rezultuar bindës shpjegimi se shtetasi A. D. (blerësi), prej disa vitesh, përpara se të kryhej regjistrimi i pasurisë në emrin e tij, kishte disponibilitetin e pasurisë në fjalë dhe e përdorte atë sa herë gjendej në Shqipëri – pasi konsumi i energjisë elektrike rezultonte pikërisht në këto periudha.
- vii. Nga ana tjetër, fakti që nënshkrimi i kontratës në fjalë përkon me një datë në të cilën shtetasi A. D. nuk gjendej në territorin e Shqipërisë, pakica vlerëson se, ndonëse në vetvete kjo rrethanë përbën një problem lidhur me besueshmërinë e datave të akteve noteriale, por nuk mund të passjellë pasoja direkte për subjektin, pasi nuk rezulton se ai të ketë qenë në dijeni të mosprezencës së palës tjetër në Shqipëri në atë datë dhe as nuk ka deklaruar të ketë qenë njëkohësisht përpara noterit bashkë me palën blerëse, por ka dhënë shpjegimet

përkatëse mbi këtë rrethanë. Për rrjedhojë, vlerësohet se subjekti nuk mund të ketë cenuar besimin e publikut për një akt të hartuar nga noteri përkatës, vetëm për shkak se ai e ka nënshkruar kontratën pa prezencën e palës blerëse – e cila teorikisht mund të ishte paraqitur te noteri një moment tjetër të po të njëjtës datë. Sipas pakicës, do të ngriheshin me të drejtë dyshime mbi etikën e subjektit në rast se ky i fundit do të kishte nënshkruar një kontratë, në përmbajtjen e së cilës gjendeshin të dhëna esenciale të pavërteta apo të deformuara me qëllim mashtrimin e palëve të treta ose përfitimin pasuror nga ana tij në mënyrë të paligjshme, por nuk është ky rasti.

- viii. **Nga sa më lart, pakica arrin në përfundimin se, nëse vlerësimet do të ishin kryer si më lart, duke konsideruar huan e dhënë nga shtetasi F. A. me burime të ligjshme, sikurse edhe të ardhurat nga shitja e pasurisë nr. 1 – të cilat do të mbulonin edhe investimet e pasurive të tjera të blera më pas nga subjekti, pa krijuar mungesa të mëtejshme të mjeteve monetare – pamjaftueshmëria e përgjithshme financiare e familjes së subjektit, që do të rezultonte rreth 1.200.000 lekë, si dhe pasaktësitë e deklarimeve, të përshkruara dhe të argumentuara edhe nga shumica në këtë vendim, nuk janë me një peshë specifike të tillë, që të krijojnë bindjen se ato në vetvete mund të përbëjnë shkak për përfundimin e procesit me vendim përfundimtar vetëm mbi një kriter, pasi ky qëndrim ka hequr mundësinë e një vendimmarrjeje mbi të tria kriteret, duke e vlerësuar në tërësi këtë proces dhe jo në raport të drejtë me faktet e provuara dhe në kundërshtim me parimin e proporcionalitetit. Kjo nuk do të thotë që pozicionimi im, pas riçeljes së hetimit, nuk do të mund të ishte për të njëjtin vendim përfundimtar, të shkarkimit të subjektit, por kjo mund të realizohej vetëm nëpërmjet një vlerësimi më të gjerë dhe më të thelluar, duke u bazuar dhe duke mbajtur në konsideratë dhe përdorur edhe elementet e gjetjeve të dy kritereve të tjera.**

PËR KËTO ARSYE,

Unë, si anëtar në pakicë, vlerësoj se vendimi i shumicës së trupit gjykues për të përfunduar procesin e rivlerësimit të subjektit Dritan Marku vetëm mbi një kriter, nuk është i drejtë, pasi çmoj se do të duhej të riçelëj hetimi administrativ edhe për dy kriteret e tjera të rivlerësimit dhe të arrihej rrjedhimisht në një vendim më të bazuar.

**Anëtari në pakicë/kundër
Lulzim Hamitaj**